



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr.71, datë 10.06.2024

PËR
“TRANSFERIM TË PËRKOHSHËM ME PËLQIM”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 46 pika 1, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a”, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 5 pika 5 dhe 6 pika 5 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të prokurorit”, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Zonja Blerina Musabelliu, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, transferohet përkohësisht me pëlqimin e saj, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
2. Zonja Blerina Musabelliu do të ushtrojë detyrën e Prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, përkohësisht nga data 10.06.2024 – 09.12.2024.
3. Të njoftohen për këtë vendim zonja Blerina Musabelliu, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
4. Gjatë periudhës së transferimit zonja Blerina Musabelliu do të përfitojë shtesë mbi pagën referuese bazë, sipas përcaktimeve të vendimit Nr.386, datë 30.11.2023, për miratimin e Rregullores për “Caktimin e procedurës dhe masës së trajtimit financiar të prokurorit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, për caktimin e përkohshëm dhe caktimin për një çështje të veçantë”.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 10.06.2024.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj



ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Nurihan Seiti



ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza



ANËTAR
Moisi Duda



ANËTAR
Vatë Staka



ANËTAR
Olger Eminaj